

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) u mbajt në datë 21 qershor 2023, në ambientet e Hotel Tirana Internacional. Në këtë takim morën pjesë edhe anëtarët e Grupit Drejtues për Migracionin (ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 35, datë 10.3.2021). Në takim u ftuan dhe morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të përfshira dhe organizatat ndërkombëtare. Takimi pati në fokus të diskutimit problematikat e dala gjatë zbatimit të strategjisë dhe rekomandimet e Raportit përfundimtar të Progresit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019-2022. Në takim u miratuan qëllimet politike dhe objektivat strategjike.

Me qëllim vijimin e punës në përputhje me prioritet e përcaktuara Ministria e Brendshme me mbështetjen e IOM kanë organizuar disa workshop-e kombëtare, në datat 9, 10 dhe 19 maj 2023. Workshop-et informuese të datave 9 dhe 10 maj kanë qenë të lidhura me zbatimin e Paktit Global për Migracionin (GCM) dhe identifikimin e objektivave prioritarë të tij që do të përfshihen në dokumentin strategjik.

Më 9 Maj 2023 u zhvillua një workshop-i me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të Qeverisë së Shqipërisë dhe më 10 Maj 2023 një workshop me partnerët dhe grupet e interesit, ku morën pjesë përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri, shoqëria civile, sektori publik, academia etj.

Në datën 19 maj 2023, Ministria e Brendshme organizoi, me mbështetjen e IOM-it, një tjetër workshop “Për vlerësimin e situatës aktuale dhe prioritetëve kryesore në fushën e migracionit në Shqipëri, në funksion të hartimit të draftit të ri. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit”. Në këtë takim punë morën pjesë përfaqësues të grupit ndërinstitucional për hartimin e Strategjisë, përfaqësues nga MB dhe institucionet kryesore përgjegjëse për migracionin, si dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga IOM. Gjatë takimit u prezantua një kornizë/strukturë fillestare e Strategjisë së ardhshme nga Sekretariati Teknik për Migrim në MB dhe ekspertë mbështetës të IOM-it.

Në datat 20-21 Shtator 2023, u zhvillua në Pogradec një workshop mbi hartimin e Strategjisë Kombëtare Për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024-2030, ku ishin të ftuar, anëtarët e GNP-së, si dhe përfaqësues të të gjithë institucioneve të parashikuara si zbatuese kryesore dhe bashkëzbatuese të ndërhyrjeve konkrete. Workshopi u moderua dhe monitorua nga Sekretariati Teknik për Migracionin në MB, dhe ekspertët e IOM..

Gjithashtu, është parashikuar edhe publikimi në RENJK për periudhën 6 nëntor 2023 deri në 6 dhjetor 2023, në respektim të afateve ligjore.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprahe nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin **“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026** janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.33 datë 13.3.2023 “Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Brendshme për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit”.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin,
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin,
- Ekspertët e IOM,
- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I	Justifikimi
--------------------	---------	---------------------	----------------------	-------------

<i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	pranuar pjesërisht/I refuzuar)	